

LIGJ
Nr.9378, datë 28.4.2005

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN QË NDRYSHON
NENET 1(A) DHE 14 (1), (3)(B) TË MARRËVESHJES EUROPIANE TË 30 SHTATORIT
1957 PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE TË
RREZIKSHME (ADR), BËRË NË GJENEVË MË 28 TETOR 1993**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin që ndryshon nenet 1(A) dhe 14 (1), (3)(B) të Marrëveshjes Europiane të 30 shtatorit 1957 për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR), bërë në Gjenevë më 28 tetor 1993.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.4570, datë 12.5.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

PROTOKOLL AMENDUES

**I MARRËVESHJES EUROPIANE TË 30 SHTATORIT 1957 NË LIDHJE ME TRANSPORTIN
NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME (ADR) PËRKATËSISHT
NENIN 1 (A), NENIN 14 (1) DHE NENIN 14 (3) (B)**

Palët e këtij protokollit,

duke pasur në konsideratë dispozitat e Marrëveshjes Europiane në lidhje me Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR), bërë në Gjenevë më 30 shtator 1957 (këtej e tutje e quajtur “Marrëveshja”), në lidhje me termin e përcaktuar “mjet” në nenin 1 (a) dhe procedurën për amendimin e shtojcave të Marrëveshjes, veçanërisht dispozitën e nenit 14 (1) të Marrëveshjes;

duke vënë re se gjatë procedurës për amendimin e shtojcave Palët Kontraktuese të Marrëveshjes kanë hasur vështirësi në zbatimin, brenda kufijve kohorë, të parashikuar në nenin 14 (3) të Marrëveshjes, e masave të brendshme që kërkojnë hyrjen në fuqi të amendamenteve;

duke vënë re më tej pikëpamjet e grupit të punës mbi transportin e mallrave të rrezikshme të Komitetit të Transportit Tokësor të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Europën dhe propozimet nga Qeveritë e Austrisë dhe Francës për të amenduar Marrëveshjen,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Amendamenti i nenit 1 (a) të Marrëveshjes

Neni 1 (a) i Marrëveshjes do të amendohet për t'u lexuar si më poshtë:

“(a) Termi “mjet” nënkupton çdo automjet, përveç një mjeti të varur nga ose nën urdhrat e Forcave të Armatosura të një Pale Kontraktuese, për përdorim në rrugë, i kompletuar ose i mangët, që ka të paktën katër rrota dhe një shpejtësi maksimale të projektuar që i tejkalon 25 km për orë, si dhe trajlerin e tij, me përjashtim të mjeteve të cilat udhëtojnë mbi hekurudha, traktorëve bujqësorë dhe pyjore dhe të gjitha makinerive të lëvizshme.”

Neni 2

Amendamenti i nenit 14 (1) të Marrëveshjes

Neni 14 paragrafi (1) i Marrëveshjes do të amendohet për t'u lexuar si më poshtë:

“1. Në mënyrë të pavarur nga procedura e rishikimit që parashikohet në nenin 13, çdo Palë Kontraktuese mund të propozojë një ose më shumë amendamente për shtojcat e kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim duhet të përcjellë tekstin te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm, gjithashtu mund të propozojë amendamente për shtojcat e kësaj Marrëveshjeje me qëllim sigurimin e harmonizimit ndërmjet këtyre shtojcave dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare, në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme.

Përveç kësaj, ai mund të propozojë amendamente të shtojcave të kësaj Marrëveshjeje, të cilat janë miratuar nga grupi i punës mbi transportin e mallrave të rrezikshme i Komitetit të Transportit Tokësor të Komisionit Ekonomik për Europën i Kombeve të Bashkuara, me kërkesë të grupit të punës.”

Neni 3

Amendamenti i nenit 14 (3) të Marrëveshjes

Neni 14 paragrafi (3) (b) i Marrëveshjes do të amendohet për t'u lexuar si më poshtë:

“(b) Pala Kontraktuese ose, sipas rastit, Sekretari i Përgjithshëm, duke paraqitur amendamentin e propozuar, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, mund të specifikojë në propozim, me qëllim hyrjen në fuqi të amendamentit, nëse pranohet, një afat më të gjatë se tre muaj”.

Neni 4

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi

1. Palët Kontraktuese në Marrëveshje mund të bëhen Palë Kontraktuese të këtij protokollit:

- a) Duke e nënshkruar atë;
- b) Duke e depozituar instrumentin e ratifikimit, pranimit ose miratimit në vijim të firmosjes subjekt ratifikimi, pranimi ose miratimi;
- c) Duke depozituar instrumentin e pranimit.

2. Ky protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim në zyrën e Sekretarit Ekzekutiv të Komisionit Ekonomik për Europën, Gjenevë, nga 29 tetori 1993 deri në 31 janar 1994.

Neni 5

Depozitimi

Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky protokoll do të hyjë në fuqi një muaj mbas datës në të cilën të gjitha Palët Kontraktuese të Marrëveshjes e kanë nënshkruar atë pa rezerva ndaj ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit ose pasi kanë depozituar instrumentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

Neni 7

Çdo shtet, i cili bëhet palë e Marrëveshjes pas përmbushjes së kushteve të hyrjes në fuqi të

këtij protokolli, në përputhje me nenin 6, do të konsiderohet si Palë Kontraktuese e Marrëveshjes siç amendohet nga protokolli.

Neni 8

Originali i këtij protokolli, tekstet anglisht dhe frëgjisht të të cilit janë njëlloj të vlefshme, do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuar.